REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

Komiteti për Politikë e Financa

I.Numër: 01-060/01-48444
Pejë, datë: 21 korrik 2026

P R O C E S V E R B A L

Nga takimi i **VI**-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **21 korrik 2026**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, Drejtoria për Bujqësi, Z.Tahir Shala, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëheqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë.

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent u miratua ky rend dite,

1. Aprovimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 15.05.2026 dhe 17.06.2026.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetimit të Komunës së Pejës dhe participimi nga qytetaret (fermerët përfitues) në projektin furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për formimin e grupit punues për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2026.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2026.
7. Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2025 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2025.
8. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmëirsë dhe testit të maturës.
9. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.

2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
Nuk ka pasur.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 15.05.2026 dhe 17.06.2026.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marin pjesë në votim, miratohen procesverbalet e dates 15.05.2026 dhe 17.06.2026.

3.Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetimit të Komunës së Pejës dhe participimi nga qytetaret (fermerët përfitues) në projektin furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: meqenëse e keni drejtorin prezent, po j'a kaloj fjalen për një prezentim të shkurt.

Z.Tahir Shala: ky është një projekt i drejtorisë së bujqësisë dhe i kalu të gjitha procedurat ligjore. Në janar kanë filluar procedurat dhe kanë kaluar të gjitha, por tani është një proces nga Ministria e Financave për pjesen e 40% të participimit të fermerve. Tash duhet me kalu dhe me u votu në kuvend, në menyrë që me pas drejt komuna e Pejës me pagu operatorin për pjesen 40% të fermerve.

Znj.Kaltrina Lajqi: a kanë qenë të informum këta fermer se sa ka qenë vlera e një traktori? Sepse mu duk pak e lartë shuma mbi 4 mijë euro për participim.

Z.Ardit Berisha: tek kjo pika e rendit të dites me sa e di unë këta traktor ju janë nda fermerve. Nuk po e kuptoj rekomandimin për buxhetin nga komuna e Pejës përderisa ata traktor janë nda, ka shku procodura e ndarjes dhe tash buxheti pas ndarjes ketë sqarim me na jep drejtori!

Z.Naim Bytyqi: ne si Aleancë e kemi ngrit ketë shqetësim për ndarjen e këtyre mekanizmave bujqësore(traktorëve). Deshta me pyet drejtorin që ky traktor e ka pas çmimin 9.500 euro ndërsa në dokumenta të prokurimit 10.780 euro? pse traktori është dasht me u zgjedh mekanik e jo hidraulik? Duke e ditur se me punu sot me traktora mekanik është diçka e pa pranushme. Unë i kam gjitha dokumentat që i kam rrujt për asamble, edhe për qeshtjen e ofortuesit tjeter që është refuzu dhe kjo ska të bej me drejtorin por me prokurimin. Në ketë procedurë ka shumë shkelje dhe ne do të vazhdojmë tutje në asamble komunale. Të gjitha kriteret ju kanë përshtat vetem operatorit Haxhi Jaha , dhe aty ka pas edhe zgjedhje të tjerë me çmim më të lirë dhe traktori me qenë edhe me kabinë dhe me qenë hidraulik. Ne nuk jemi kundër vetem qite kriterin. Nese na e kishim qit kriterin që po dojmë me ju jep njerzëve që kanë punët më së miri në Pejë, athere qeto kriteri i keni vendos ju!

Z.Labinot Panxha: po nderlidhna me parafolsit e sidomos me znj. Kaltrina, edhe une konsideroj që shuma është shumë e lartë me pagu një fermer. Nuk e di a ka pas mundësi tjeter me pagu ma pak, po 40% e shumes përafersishtë 5.000 euro, ndoshta vetem edhe pak me u perpjek një fermer e kish ble edhe vet sepse pak e nalt si shumë. Pjesa tjeter se nese hapet një tender kanë me u përpjek me ofru mjetet jo adekuate, sigurishtë që ligji i prokurimit e parasheh që oferten me të lirë me mar që i përgjigjet qasaj natyre. Por nese ka ndodh një gjë e tillë mendoj qe ka shkelje, por edhe për ate pjese mendoj që ka kush i ndjek kto procedura, dhe nuk është faji i drejtorit sa i pë rket prokurimit. Ndërsa tek pjesa ku fermeret kanë apliku edhe kjo konsideroj që është në përgjegjësin e fermerit nese ka mashtru a po jo! Sepse janë do kritere që ish dasht me i plotësu, dhe nese ka mashtru unë konsideroj që kishte me qenë e ndershme që drejtori me mar dokumentacionin e tij dhe me qu në prokurori dhe me deklaru që ky ka mashtru. Po ashtu edhe pjesa tek fermeret a i ka hetu dikush sepse nese ka përfitu njëhere nuk ish dasht me me marr traktor? Krejt çka du me thënë unë se nese qeky proces ka shku në rregullë dhe nuk janë bë shkelje se une nuk jam marr me ketë pjesë, por Naimi është marr dhe ka reagu ne ketë temë. Unë jam pro me i ndihmu fermerve, por a është në rregullë qe kanë pagu më shumë se 4.000 euro mendoj që është shumë, por ne fund fermeret kanë qenë të informuar se kanë me pagu 40%.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: deshta me u nderlidh tek kriteret 65 perfitues që janë mendoj qe edhe 150 perfitues janë që e meritojnë.

Z.Naim Bytyqi: unë kam punu 25 vjet me fermer dhe nuk du me perdor politikisht çështjen e fermerve, sepse kurgjo nuk na bojnë nder as gjykata as kurgjo, kokan 10 gabim ose 20 prej 65 po përmirsojeni gabimin , zavendosojeni dhe jemi në rregullë.

Z.Labinot Panxha: nese në oferte aty ka qenë 10.800 euro qeky me kabinë, dhe është shpërnda qeky pa kabine mekanikë, fermeri qe e ka pranu dhe nese ka qenë qeky 10.800 euro si në foto është dasht me mar me kabinë.

Z.Bekim Morina: çeshtjet e prokurimit i mbeten prokurimit dhe normal që janë njesit të cilat e hetojnë. Kriteret kanë qenë dhe në bazë të tyre është bë edhe përzgjedhja dhe sigurishtë çmimi më i ultë luan rol të madh. Ne e kemi pas si premtim për fushat dhe atëhere e kam kundershtu kryetarin , sepse më mirë kishte me qenë me i ndihmu fermerit me paisje me të vogla e me pas me shumë gjithëpërfshirje. Tek kriteret e ndarjes se traktorëve aty është një komision që i shqyrton gjitha aplikacionet. Edhe pse kriteret kanë qenë shumë të ashpëra dhe nuk besoj që të gjithë i kanë plotësu gjitha kriteret, por po besojmë që i kemi zgjedhë më të miret perderisa nuk kemi argumente kundër!

Z.Ardit Gërvalla: kur ka ardh thirrja për shperndarjen e traktorëve, unë kam mendu që kanë me qenë traktor më të mirë në kuptimin që ka mi ndihmu një fermerit me punu token. Këta traktor po shihen si përpara qe kanë qenë për një hektar tokë, mirpo tash ka kalu fuqia në një tjeter dimension. Tek çështja e participimit nese kishin qenë këta traktor më të mëdhënje më të mirë edhe 50% me participu, sepse fermeri kujdeset ma mire dhe nuk thot ma fali komuna, por nifar lloj ndihmese. Ndërsa kur po flasim për fermeret meritor duhet me pas parasysh vetem një gjë për cilin fermer po flasim? Sepse fermeri meritor i ka 5 traktor te shpija dhe i punon 30 hekter tokë. A është politike e komunes me rrit numrin e fermerve, fermerve të ri me ju ndihmu atyre me hy ne tregun e bujqësisë, apo ai fermeri meritor që e ka dëshmu edhe ne fshat? Mendoj që ne thirrjet të tjera specifikat me qenë ndryshe dhe traktoret më qenë më të mire, jo ketë lloj traktori sepse une kur e pash ketë traktor qe u shpernda u qudita!.

Z.Tahir Shala: sa i perket pytjes Kaltrines sa i perket shumes, fillimishtë nuk e ka ditë shumen por ne e qesim një paramasë sepse kur kanë apliku ata na nuk kemi pas as kontratë, nuk paten fillu procedurat tenderuse, 100% dihet vetem pasi të nënshkruhet kontrata.

Z.Ardit Gërvalla: qysh është parapa në kontratë mbikëqyrja e traktorëve?

Z.Tahir Shala: secili qe ka nënshkru dje një kontratë shkruhet se 5 vjet ne kemi drejtë në mbikqyrje. Sa i perket satistikave të traktorit ne kemi pyet fermeret se cili është ma i mire. Sa i perket operatoreve kanë qenë dy ky qe e ka fitu dhe tjetri qe ka pas oferten me të lire por

dokumentacionin nuk e ka pas në rregullë . Unë mendoj që si traktor është më i mire i mundshëm, dhe shumë i modifikuar. Ka pas traktorë edhe me kabine por 1 mijë euro më shtrejtë. Sa i perket përzgjedhjes aty kanë qenë kriteret dhe kemi thenë një prej atyre kritereve me plotësu.

Nga të gjithë anëtret prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim me 5 votë pro, 1 votë kunder, dy anëtar të përmbajtur dhe 1 anëtar nuk ka mar pjesë në votim.

4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për formimin e grupit punues për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ky komision përbëhet nga 7 anëtar, kryesusi dhe sekretari i Kuvendit shkojnë me automatizem, dhe nga një anëtar nga subjetet politike. Ky plan del edhe në diskutim publik gjithashtu edhe meren rekomandimet edhe sugjerimet nga ekzekutivi.

Unanimishtë nga të gjithë anëtaret prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

5.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: raportin e keni si material që është dërgu nese ka dikush diqka për sqarim, hapim diskutimin.

Z.Ardit Gërvalla: unë e kam një vërejtje me lidhje me materialet që pa dergohen, ky material na ka ardh dje dhe është koha e pa mjaftushme që na me i lexu dhe me i shqyrtu një ditë përpara. Kërkoj që materialet të na dërgohen 3-4 ditë përpara me pas kohë me i shqyrtu materialet.

Nga të gjithë anëtret prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marin pjesë në votim.

6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2026.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: a ka dikush diqka për diskutim , nese nuk ka e qesim në votim.

Nga të gjithë anëtret prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim me 4 votë pro, 5 anëtar nuk marin pjesë në votim.

7.Shqyrtimi dhe rekomandimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2025 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni marr, nese ka diqka për sqarim e hapim diskutimin.

Nga të gjithë anëtret prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim me 4 votë pro, 5 anëtar nuk marin pjesë në votim.

8.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmëirsë dhe testit të maturës.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: drejtori e ka dërgu një material si informatë, por nuk është prezent nese ka dikush diqka për sqarim e hapim diskutimin.

Z.Tahir Shala: po ndërlidhna me ketë teme pasi që kam punu një kohë në arsim. Sa i perket prezentimit që po i qesin shkollat me rend në list, nuk mundet me qen i saktë. Sepsee nëper fshatra është vetem një paralele në gjeneratë, ndërsa në qytet i ki 4 paralele. Kryesishtë shkollat në qytet kanë me dal ma mirë se ne fshat. Këtu duhet me dal si rezulltat i përgjithëshem dhe pastaj me diskutu se nuk mundet me dal shkolla e parë, shkolla fundit nuk është realiteti i përgjithëshem.

Z.Labinot Panxha: mbasi Tahiri e nisi si temë edhe unë po du me tregu se njera prej faktorëve kryesore që ka ndiku se shkolla "Migjeni" në Gllogjan nuk ka arsimtare të anglishtes prej muajit shkurt. Kjo do të thotë se një nxënës i asaj shkolle me i ra ne test anglishtë ai nuk din dhe per ketë arsye përqindja është aq e vogel. Por me dal një institucioni private më mirë se institucionet publike kjo domethonë diqka, por si rezulltat i përgjithëshem është shumë shqetësuese.

Nga të gjithë anëtaret prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim me 4 votë pro, 5 anëtar nuk marin pjesë në votim.

9.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.

Z.Ardit Gërvalla: sa i perket çështjeve të ngritura KPF-ja nuk mundet me tejkalu ketë mbledhje pa diskutu pak për gjendjen në Sferkë. Kishte me qenë mirë pasi që tani ka kalu edhe në dëme në njerzë siq e pam edhe në raportime në media, qe kanë dal edhe ne ndihmë disa qytetarë. Kisha dasht me dit prej kryesuesit ketë rast se qysh qëndron situata atje? Unë dje e kam bë një status por mendoj qe i ka tejkalu komplet përgjegjësin se a i ka fajet , Ambienti, kryetari a ministri, por mbasi e kemi edhe Ambientin në menaxhim të komunes me dit pak a shumë qysh o gjendja a është ndal zjarri? Sepse disa informacione qe kam mar po thojnë qe ka disa kimikate shumë të rrezikshme. Tek çeshtja e dyte qka ka ndodhe me plotësim ndryshimin e statutit të komunes?

Z.Tahir Shala: sa i perket deponisë në Sferkë ne e kemi pas një marrveshje me Gizin por 4 vite ne i kemi pas të bllokume fondet. Sepse nese si kishim pas fondet e bllokume ish mbyllë kjo dhe

ish hap tjetra dhe qeshtu funksionon. Ne jemi duke mendu me bo marveshje me Istog sepse ne e dim qe rrezikshmeria është e madhe.

Z.Labinot Panxha: me rëndësi është me dit se kush është shkaktar i zjarrit! Ndërsa qytetarët që po dalin me protestu qaty dikush duhet me ju bo thirrje qoftë policia sepse protestat në rregullë janë duhet me protestu ama jo qaty! Përderisa po thojmë që ne në qytet po helmohemi qka ndodh me ata 500 m afër. Për këtë komuna duhet me ndërmarr hapa dhe me i largu ata prej atij vendi protestuesit dhe me j'a caktu një vend tjeter.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: prokupimi kryesor është se qysh me dal nga kjo gjendje!

Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 12:15 h.

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina

K R Y E S U E S I,
z. Rexhep Kurtbogaj